

Data 11.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje bojë për sinjalistikë rrugore

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44811000-8 Bojra për rrugë

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,497,950 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Certifikatë ISO 9001-2015 (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 2, gërma a) dhe vlerën e xhiros minimale vjetore e ka përcaktuar brenda kufirit maksimal të lejuar nga ky nen. Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklarats vjetore pranë organeve tatimore).

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që

kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2. Autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për bojrat, fosforin dhe diluentin, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (**referoju shtojcës 7**) në amballazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se malli objekt prokurimi do të jetë i prodhuar jo më herët se **3 (tre) muaj** nga data e lëvrimit të mallit pranë AK. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se për një periudhë të arsyeshme boja do të ketë efektshmëri të lartë gjatë aplikimit me qëllim jetëgjatësi më të madhe.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdher të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për bojra të cilat shërbejnë për mirëmbajtjen e vijëzimeve ekzistuese dhe aplikimin e vijëzimeve të reja në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë.

Konkretisht boja bikomponente paste dhe spray shërben për vijëzime të tipologjive të ndryshme, të reja ose ekzistuese ndërsa boja akrilike shërben për vijëzime të përkohshme gjatë punimeve në rrugë.

Fosfori shërben për t'i dhënë bojës efektin e reflektivitetit sipas kërkesave teknike gjatë aplikimit të saj. Përkatësisht fosfori i tipit 125-850 me bojën bikomponente spray Diluenti, skotchi dhe letra rulo shërbejnë si materiale ndihmëse gjatë procesit të aplikimit të bojërave.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT